

Shenime mbi pasqyrat financiare

“Ylli Merja” PF

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

1. Informacion i përgjithshëm.

Ylli Merja është regjistruar si person fizik, date 04.03.2008, regjistruar në Drejtorine Rajonale Tatimore, Tirane me nipt K815040400.

Veprimtaria rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” i ndryshuar dhe Legjislacioni ne fuqi.

Objekti i veprimtarisë është: Tregeti me pakice dhe shumice i produkteve ushqimore, çajra, erza dhe paketimi i tyre, ekstraktime te bimeve eterovajore dhe import eksport. Prodhim te vajrave te ndryshme bimore me presim te ftohte si vaj liri, kungulli, sinapi, hudhre, kokosi, luledielli, basani etj. Vajra bimore me distilim, rigon, livando, sherebele etj. Laborator per analiza te bimeve dhe mjekesor, kremra bimore, shampo me vajra bimore, perpunime te produkteve bujqesore. Prodhim raki artizanale. Sherbime te mjeksise popullore. Klinike mjeksore, laborator mjekesor, sherbime kurative.

Selia e Shoqërisë është në Lagja: Rruga Ferit Xhajko, Pallati SIMED, nr.11, Kati 1, Tirane.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi



The image shows a handwritten signature in black ink over a circular official stamp. The stamp contains the text "PRODUKTE USHQIMORE", "YLLI MERJA PF", "TIRANE", and "ALBANIA".

Shenime mbi pasqyrat financiare

“Ylli Merja” PF
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

1. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

1.1 Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë të këmbimit në monedhën funksionale me

Shenime mbi pasqyrat financiare

“Ylli Merja” PF

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

1.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.


- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna



Shenime mbi pasqyrat financiare

“Ylli Merja” PF
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

1.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

1.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e

Shenime mbi pasqyrat financiare

“Ylli Merja” PF

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Paj, zyre e informat	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten

Shenime mbi pasqyrat financiare

“Ylli Merja” PF

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjate materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.


3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 10.3% (2018: 5.2%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.



Shenime mbi pasqyrat financiare

“Ylli Merja” PF

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.


3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

AKTIVET AFATSHKURTRA

Aktive monetare për 1.657.198 lekë, perfaqesojnë mjete monetare ne banke.

Shoqëria operon me disa banka leke, usd dhe euro, te gjitha veprimet jane regjistruar ne ditaret perkates, me llogarite ne valute veprimet i shprehin me kursin ditor te bankes, ndersa gjendja e



Shenime mbi pasqyrat financiare

“Ylli Merja” PF
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

monedhave te huaja ne fund te ushtrimit eshte vleresuar me kursin e Bankes se Shqiperise me date 31.12.2019 duke kaluar sipas rastit ne llogarite e shpenzimeve apo te ardhurave diferencat e kembimit.

Te tjera te drejta te arketueshme ne shumen 2.233.493 leke paraqet **Tvsh** ne te njejten shume. Ne llogarite **Inventariale** eshte paraqitur gjendja e mallrave ne shumen 21.448.204 leke. Vleresimi i tyre ne fund te ushtrimit eshte bere me kosto faktike.

Aktivitet afatgjata materiale

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh afatgjata materiale ne shumen 15.682.482 lekë e cila perfaqeson vleren e mbetur te nderteses, makinerive e pajisjeve te punes, mjeteve te transportit dhe te zyres. Aam jane shtuar gjate vitit 2019 ne shumen 7.075.508 leke ne zerin ndertime, makineri pune, mjete transporti e pagesa per leje ndertimore dhe jane pakesuar per amortizimin e llogaritur ne shumen 1.241.079 leke.

DETYRIMET DHE KAPITALI

Kapitalet e veta paraqiten me vlerë 3.399.556 leke e cila eshte edhe fitimi i ushtrimit.

Detyrimet

Detyrimet me vlerë 37.621.821 lekë përfaqësojnë:

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	7.866.416	8.791.185
Te pagueshme ndaj punonjesve e sigurimeve shoqerore	2.146.651	2.726.417
Detyrime tatimore	464.564	614.732
Te tjera detyrime	27.144.190	18.564.492
Totali	37.621.821	30.696.826

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit per 7.866.416 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore paraqitet detyrim per pagat ne shumen 1.972.999 leke dhe sigurime per muajin dhjetor 2019 ne shumen 173.652 leke.

Detyrimet tatimore paraqesin: **Tatimi mbi fitimin** per 464.564 leke.

Te tjera kerkesa ne shumen 27.144.190 leke paraqet detyrim te shoqerise ndaj personit fizik per mjete financiare te futura ne aktivitet.

Verifikimi i llogarise Fitime Humbje

Shpenzimet dhe të ardhurat janë grupuar si më poshtë:

Shenime mbi pasqyrat financiare

"Ylli Merja" PF

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

	Viti 2019	Viti 2018
Te ardhura		
Nga shitja e mallrave dhe sherbimeve	33.190.279	25.456.608
Totali i te ardhurave	33.190.279	25.456.608
Materiale te konsumuara	18.581.358	17.293.126
Kosto e punes	6.362.937	4.464.877
Pagat e personelit	5.267.000	3.825.944
Shpenzimet per sigurime	1.095.937	638.933
Amortizimi dhe zhvleresimet	1.241.079	800.194
Shpenzime te tjera	2.955.127	1.328.977
Totali i shpenzimeve	29.140.501	23.887.174
Te ardhura te tjera		
Diferencat nga kembimi	(2.040)	47
Fitimi bruto	4.047.738	1.569.481
Tatim fitimi	648.182	260.178
Fitimi neto	3.399.556	1.309.303

Shpenzimet jane 29.142.541 leke, ndersa te ardhurat 33.190.279 lekë. Rezultati neto i realizuar nga veprimtaria gjate ketij viti ushtrimor është fitim ne shumen 3.399.556 leke.

Te ardhurat e realizuara gjate ushtrimit perfaqesojne: te ardhura nga shitja e mallrave dhe sherbimeve ne shumen 33.190.279 leke.

Shitjet jane rregjistruar korrekt ne librat e shitjeve dhe te ardhurat rakordojne me situaten tatimore.

Shpenzimet per 29.142.541 lekë, jane te justifikuara me dokumenta te rregullta fiskale. Më konkretisht shpenzimet sipas zërave janë si më poshtë:


Shpenzime per materiale ne shumen 18.581.358 lekë, ato janë përdorur për veprimtarinë kryesore të shoqërisë, këto shpenzime janë të justifikuara me dokumenta te rregullta tatimore.

Personeli, në këtë llogari janë pasqyruar shpenzimet për paga 5.267.000 lekë, sigurime shoqërore 1.095.937 lekë, listëpagesat janë përpiluar saktë dhe shpenzimet për paga e sigurime janë vendosur korrekt në këtë llogari.

Amortizimi ne shumen 1.241.079 leke nuk kalon kufijte tatimor.

Shpenzime te tjera per 2.955.127 leke paraqesin:

- shpenzime per qera ne shumen 458.000 leke,
- shpenzime transporti ne shumen 1.036.725 leke,
- shpenzime komisioni banke ne shumen 68.906 leke,
- shpenzime taksa, tatime ne shumen 750.095 leke,
- shpenzime mirembajtje ne shumen 164.792 leke,
- shpenzime per telefon ne shumen 37.293 leke,
- shpenzime gjoba ne shumen 273.477 leke.



Shenime mbi pasqyrat financiare

"Ylli Merja" PF


(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

- shpenzime te tjera ne shumen 165.839 leke.


Rezultati ushtrimor neto i realizuar gjate 2019 është fitim 3.399.556 leke.

Administrator

Ylli Merja



A handwritten signature in black ink is written over a circular stamp. The stamp contains the text 'PRODUKTE USHQIMORE' at the top, 'YLLI MERJA' in the center, and 'TIRANE - ALBANIA' at the bottom. The signature is stylized and extends across the stamp.



A second handwritten signature in black ink is written over an identical circular stamp as above. The stamp contains the text 'PRODUKTE USHQIMORE' at the top, 'YLLI MERJA' in the center, and 'TIRANE - ALBANIA' at the bottom. The signature is stylized and extends across the stamp.